



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 1**

Rrogozhinë, më 23.06.2023 ora 10 : 30<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e parw e konstituimit tw Këshillit Bashkiak tw ri, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të thirrur nga Sekretari i Këshillit Bashkiak me Nr.2180.Prot datë 19.06.2023 si më poshtë :

1. Konstituimi i Këshillit Bashkiak.
  - Zgjedhja e Komisionit të mandateve.
  - Verifikimi i mandateve dhe miratimi i raportit të komisionit të mandateve.
  - Betimi i Këshilltarëve dhe nënshkrimi i aktit të betimit.
2. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë.
  - Propozim i kandidatëve nga grupet e Këshilltarëve.
  - Zgjedhja e komisionit të votimit, (si rregull 3 anëtarë).
  - Përgatitja e fletëve të votimit dhe votimi.
  - Shpallja e rezultateve të votimit dhe kalimi i drejtimit të mbledhjes Kryetarit të Këshillit të sapozgjedhur.
3. Zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të Këshillit Bashkiak.
  - Miratimi me votim i numrit të zëvendëskryetarëve të Këshillit Bashkiak.
  - Propozim i kandidatëve për zëvendëskryetarë.
  - Përgatitja e procedurave të votimit, kryerja e votimit.
  - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të Këshillit Bashkiak.
4. Zgjedhja e këshilltarëve që do të përfaqësojnë Këshillit e Bashkisë në Këshillin e Qarkut.
  - Paraqitja e propozimeve nga grupet e Këshilltarëve.
  - Përgatitja e procedurave të votimit, kryerja e votimit.
  - Shpallja e rezultatit.

**Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Shpati Kolgega, Mukades Gixhari, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Erind Tosku, Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit



Dedej, Sadete Kaja, Bajazi Thaçi, Besnike Coraj, Saimir Cani, Altin Tosku, Fatbardha Sina, Ferdi Avdiu, Sokol Gosa, Mitat Daja.

**Të ftuar :**

1. Afrim Qëndro - Prefekti i Qarkut Tiranë.
2. Aldrin Dalipi - Kryetar i Këshillit të Qarkut Tiranë.
3. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.

**Drejton mbledhjen :**

Përkohësisht mbledhja drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë z. Lulzim Hasa deri në rizgjedhjen Kryetare të Këshillit të znj. Mukades Gixhari.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 21 Këshilltarë.

**HAPET MBLEDHJA**

**Ervis Shera .** Përshëndetje të gjithëve !

I nderuar, deputet i zonës z. Etjen Xhafaj, i nderuar Prefekt i Qarkut z. Afrim Qëndro, i nderuar kryetar i Bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla, të nderuar këshilltarë, të nderuar pjesëmarrës. Në cilësinë e sekretarit të këshillit bashkiak kam thirrur mbledhjen e parë të konstituimit të këshillit bashkiak Rrogozhinë. Meqë kemi kuorumin e nevojshëm , marrin pjesë 21 këshilltarë mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Pas zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë rezultati i zgjedhjeve është certifikuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 622, datë 26.05.2023 dhe vendimin nr.661, datë 7.6.2023 ku është vendosur shpërndarja e mandateve për subjektet zgjedhore me këtë përbërje :

Subjekti zgjedhor Bashkë Fitojmë 4 mandate,  
Partia Socialiste e Shqipërisë 9 mandate,  
Partia Republikane Shqiptare 1 mandat,  
Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat,  
Partia Socialdemokrate 2 mandate,  
Partia Demokratike 3 mandate,  
Mitat Kadri Daja 1 Mandat.



Mandatet e mësipërme janë shpërndarë kandidatëve fitues nga listat shumëemërore për këshilltarë si më poshtë:

**Bashkë fitojmë** ; 1. Hekuran Xhani, 2 . Silvana Aliu, 3. Indrit Dedej, 4. Sadete Kaja,

**Partia Socialiste e Shqipërisë** : 1. Shpati Kolgega, 2 . Mukades Gixhari, 3. Renato Kalemi, 4. Fatmira Thartori, 5. Enver Memolla, 6. Alime Hoxha, 7. Lulzim Hasa, 8. Gezime Met-hasani, 9. Erind Tosku.

**Partia Republikane Shqiptare** : 1. Ferdi Avdiu,

**Partia Lëvizja e Legalitetit**: 1. Sokol Gosa,

**Partia Socialdemokrate** 1. Altin Tosku, 2. Fatbardha Sina,

**Partia Demokratike**: 1. Bajazit Thaçi, 2. Besnike Coraj, 3.Saimir Cani,

**Kandidat i propozuar nga zgjedhësit** : 1. Mitat Daja.

Mbështetur në pikën 5 të nenit 48 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë. Nga verifikimet e kryera këshilltari më i vjetër në moshë rezulton z. Lulzim Hasa. z. Hasa jeni i lutur të merrni përkohësisht drejtimin e mbledhjes, fjala për ju. Ju faleminderit.

**Lulzim Hasa . Faleminderit z. Sekretar!** Ju uroj suksese dhe punë të mbarë gjithë këshilltarëve për mandatin 2023-2027 dalw nga zgjedhjet e 14 Majit. Sipas rregullores sw Kwshillit Bashkiak njoftimet i keni marrë 5 ditw pwrpara qw nga data 19, Kwshilli Bashkiak konkludon me kwtw rend dite :

1.Konstituimi i Këshillit Bashkiak.

Dhe Verifikimi i vlefshmwrsw sw mandateve tw anwtarwve tw kwshillit sipas subjekteve elektoraw . Pwr kwtw do tw konkludoj ngritjen e njw komisioni pwr verifikimin e mandateve qw historikisht wshtw pwrbrw nga 3 anwtarw nga kryetarwt e grupeve ka ndonjw vwrejttje pwr numrin. Jemi dakord?

*-Miratohet numri me 3 anwtarw i komisionit tw verifikimit tw mandateve.*

I kwrkoj kryetarwve tw grupit tw kwshilltarwve propozimin e pwrbrwjes sw komisionit pwr Partinw Socialiste Enver Memolla.

**Hekuran Xhani .** Koalicioni Bashkw Fitojmw Silvana Aliu.

**Enver Memolla .** Atwherw PS duhet tw ketw dy?

**Lulzim Hasa .** Po.

**Enver Memolla .** Atwherw Shpati Kolgega, Alime Hoxha.

**Lulzim Hasa .** Miratohet Komisioni i Verifikimit tw Mandateve.

**Vendim nr. 1 .** Miratohet ngritja e Komisionit tw Verifikimit tw mandateve tw anwtarwve tw Kwshillit Bashkiak me kwtw pwrbrwje : Z. Shpati Kolgega- Kryetar, znj. Silvana Aliu - Sekretare, znj. Alime Hoxha - Anwtare.



**Shpati Kolgega** . Atzherw mirwditw tw gjithwve! Nw cilwsinw e Kryetarit tw Komisionit tw Mandateve dhe nw bazw tw rregullores sw Kwshillit Bashkiak do duhet tw ju lexoj

### **Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit**

1. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

- a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
- b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
- c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
- ç) funksionin e deputetit;
- d) funksionin e ministrit.

2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.

3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrrri e vjehrra me nusen e dhëndrin.

Kwto janw rastet kur mandati wshtw i papajtueshwm. Jeni tw gjithw dakord? Nwse nuk ka ... Faleminderit.

Atzherw nw bazw tw verifikimit tw mandateve dhe verifikimit tw dokumentacionit Komisioni vwrteoi se mandatet janw fituar konform kwrkesave tw kodit zgjedhor dhe ligjit nr.139/2015 “Pwr vetwqeverisjen vendore” dhe janw tw vlefshwm 21-mandate ndaj ftoj kwshilltarwt qw ta miratojnw kwtw raport. Jeni dakord?

- *Miratohet me 21-vota pro raporti i komisionit tw mandateve pwr vlefshmwrinw e mandateve tw anwtarwve tw Kwshillit Bashkiak Rrogozhinw.*

**Vendim nr . 2** . Miratohet me 21 vota pro raporti i komisionit tw mandateve pwr miratimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë pwr 21 Kwshilltarw, duke u mbwshtetur dhe nw Vendimet e KQZ-sw me nr. 622, datë 26.05.2023 dhe vendimin nr.661, datë 7.6.2023.

**Lulzim Hasa** . Pra pas miratimit tw mandateve kalojmw nw betimin e Kwshilltarwve, ngrihem tw gjithw nw kwmbw.

Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Rrogozhinë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre.

### **BETOHEM.**

*-Pas leximit tw formulws sw betimit nga drejtuesi i mbledhjes, kwshilltarwt thwrrasin njwzwri betohem. Duartrokitet nga tw gjithw pjeswmarrwsit nw mbledhje.*



**Lulzim Hasa** . Kalojmë në pikën e dytë që është zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë. Në fillim do të ngrejme komisionin për votimin e kryetarit të këshillit. Në qoftë se jeni dakord që të ishin ose zgjedhim të tjerë. Urdhëroi Enver propozoi dy anëtarë të tjerë.

**Enver Memolla** . Atëherë Erind Tosku dhe Fatmira Thartori.

**Lulzim Hasa** . Hekuran?

**Hekuran Xhani** . Indrit Dedej.

**Lulzim Hasa** . Jeni dakord me këtë propozim?

- Miratohet me 21-vota pro Komisioni i Votimit për Kryetarin e Këshillit Bashkiak.

**Vendim nr. 3** . Miratohet me 21 vota pro Komisioni i Votimit me këtë përfaqësues z. Erind Tosku - Kryetar, z. Indrit Dedej - Sekretar, zj. Fatmira Thartori-Anëtare.

**Lulzim Hasa** . Komisioni të ngrihet dhe të zgjedhi kryetarin dhe sekretarin e komisionit. Tani presim propozimet për kryetar të këshillit bashkiak.

**Enver Memolla** . Atëherë Partia Socialiste si kryetar grupi ka vendosur që të shkojë me kandidaturën e zj. Mukades Gixhari.

**Lulzim Hasa** . Hekuran?

**Hekuran Xhani** . Nëse ka mundësi në një minutë pushim sa të konsultohem.

**Lulzim Hasa** . Në një minutë pushim për zotërinë. Ndonjë grup tjetër këshilltarësh a ka propozim?

**Hekuran Xhani** . Pas konsultimit grupi jonë nuk propozon kandidat për kryetar këshilli.

**Lulzim Hasa** . Të përgatiten fletët e votimit për kandidatin zj. Mukades Gixhari dhe komisioni të vazhdojë punën. Votimi është i fshehtë, të përgatiten fletët e votimit dhe të vazhdojë votimi.

- Përgatiten 21 fletë votimi të vulosura me vulën e sekretarisë së bashkisë me emrin e kandidatit për kryetar këshilli zj. Mukades Xhaferr Gixhari dhe në kutinë e shenjës së votuesit është shkruar pro dhe kundër.

**Erind Tosku** . Atëherë në bazë të rregullores për votimin e kryetarit të këshillit bashkiak, ftoj të gjithë anëtarët në votim të fshehtë për kryetarin e këshillit bashkiak të ri sipas listës. Shpati Çelik Kolgega.

**Fatmira Thartori** . Atëherë përgatitet zj. Mukades Gixhari. Anëtarja e Komisionit thirrret me radhë emrat e këshilltarëve për të votuar: Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver



Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Erind Tosku, Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Sadete Kaja, Bajazi Thaçi, Besnike Coraj, Saimir Cani, Altin Tosku, Fatbardha Sina, Ferdi Avdiu, Sokol Gosa, Mitat Daja.

**Erind Tosku** . Atzherw tw gjithw anwtarwt e kwshillit votuan. Votimin e deklaroj tw mbyllur tani do merremi me procedurat e numwrimt dhe vlefshmwrisw sw votimit.

-Komisioni i votimit numwron votat pro dhe kundwr me zw dhe duke treguar çdo fletw votimi edhe kwshilltarwve tw pranishwm nw sallw.

47;27

*-Miratohet me 11-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Miratimi i procesverbalit nr.4, të mbledhjes së këshillit bashkiak datë 27.04.2023. E hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 3, “Miratimi i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i bllok – ndihmës 6%”. Do na e referojë përgjegjësi i Shërbimit Social z. Ledian Hasani. Përshëndetje Ledian!

**Ledian Hasani** . Përshëndetje! Në total janë 18 familje përfituese dhe fondi është 74 mijë lekë të reja.

**Mukades Gixhari** . Materialet i keni të gjithë përpara. Ka ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 11-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .17**. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1793.Prot datë 10.05.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.



**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 4, “Miratimi i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani** . Janë 16 familje përfituese dhe fondi është 55 mijë lekë të reja.

**Enver Memolla** . Është Marsi?

**Ledian Hasani** . Ky është Maji.

-3-

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje, sugjerim? E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 11 vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .18**. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1815.Prot datë 10.05.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit Ledian. Kalojmë në pikën 5 (pesë), tek të ndryshmet. Kush ka ndonjë gjë për të diskutuar? Qëndro pak z. Ledian nqs do ketë ndonjë gjë në lidhje me ju. Atëherë meqë nuk keni do ju lexoj unë disa rreshta.

Me gjasë kjo është mbledhja e fundit e këtij këshilli për mandatin 2019-2023. Dua të shpreh falenderim dhe mirënjohje për secilin prej jush që jeni në sallë si dhe për këshilltarët që nuk janë sot të pranishëm, ku falë bashkëpunimit dhe mbështetjes tuaj kemi arritur të realizojmë shumë punë të mira duke i ardhur në ndihmë të gjithë banorëve të Bashkisë Rrogozhinë. Ndjem e nderuar që kam qenë në krye të këtij këshilli dhe vlerësoj pa masë bashkëpunimin e ndërsjellë që kemi pasur përgjatë këtij mandati 4-vjeçar.

Ju faleminderit nga zemra. Kemi fituar miq të mrekullueshëm.

Mbledhjen deklarohet zyrtarisht e mbyllur rreth orës 14:05.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

**MBYLLET MBLEDHJA**



-4-

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 05<sup>00</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 5 min ; 48 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 5 (pesë).

**Miratohet procesverbali :**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**  
**Sekretari i Këshillit**  
**Ervis Shera**





-5-